



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Vijimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Shehu).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e gjashta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala, eksperte EWMI.**
- 6. {...}, përfaqësuese e ILD-së.**
- 7. {...}, magjistrat.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 9. Të tjerë.**

RENDI I DITËS:

2. Vijimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Shehu).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Fillimisht ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor është në një angazhim institucional në një Konferencë Ndërkombëtare, kështu që mbledhja e ditës së sotme datë 21.11.2023 do të drejtohet nga unë Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas rendit të ditës të njoftuar, kemi disa çështjet të cilat shqyrtohen me dyer të hapura, në komunikim me të tretët dhe një çështje është me dyer të mbyllura.

Keni ndonjë diskutim në lidhje me kronologjinë e rendit të ditës?

Po, zonja Shehu, fjala për ju.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Duke parë renditjen e çështjeve që do të shqyrtohen sot në mbledhje plenare, unë do të vlerësoja që pika e fundit e cila realizohet me dyer të mbyllura, të zhvillohet në fillim dhe fill pas saj të kalojmë tek pika 6 që lidhet me shqyrtimin e projektvendimit për vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor ndaj ish-magjistratit z. {...}, duke qenë se edhe është njoftuar për të qenë prezent në orën e caktuar. Më pas të vijojmë me pikat e tjera të rendit të ditës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime të tjera, jeni dakord me propozimet e zonjës Shehu mbi kronologjinë e trajtimit të çështjeve të ditës së sotme që janë për mbledhje plenare si rend dite?

Irena Plaku: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, si pikë e parë e këtij rendi dite do të jetë një çështje e cila për shkak të karakterit të saj është me dyer të mbyllura, kështu që i lutem administratës të largohet nga salla. Njëkohësisht edhe sektori i IT-së të bëjë ndërprerjen me të tretët.

(Pas trajtimit të çështjes së parë e cila lidhet me kualifikimin/skualifikimin e kandidatës znj. Eriona Daupaj, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2023-2024, krijohet mundësia e lidhjes me të tretët nëpërmjet platformës “online” si dhe vijon rendi me çështjen e radhës.)

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje plenare dhe sipas kronologjisë së vendosur nga po këta anëtarë në lidhje me shqyrtimin e pikave përkatëse të përcaktuara si rend dite, po vazhdojmë me pikën mbi shqyrtimi i projektvendimit “Për vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni Disiplinor. Gjithashtu nga administrata bëhem me dije që edhe përfaqësuesi i ILD-së dhe zoti {...} janë prezent. Ju lutem ftojini të marrin pjesë në këtë seancë dëgjimore.

(Futen në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...} dhe gjyqtari z. {...}.)

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Sikundër jeni njoftuar, sot mbahet seanca dëgjimore në lidhje me procedimin disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}. Është paraqitur përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me autorizimin përkatës znj. {...} e cila me autorizimin nr. {...}, datë 21.11.2023 është autorizuar për shkak të detyrës si inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor në ngarkim të magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, që do të zhvillohet në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Prezent.

Gjithashtu është paraqitur edhe zoti {...}. Prezent, faleminderit.

Duke iu referuar përcaktimeve ligjore, fillimisht fillojmë me pretendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet përfaqësueses së saj dhe sipas përcaktimeve ligjore ato parashtrësa të cilat janë paraqitur me shkrim, mirë është të mos përsëriten. Faleminderit! Fjala për ju!

{...}: Përshëndetje!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. {...} prot., datë 08.10.2021 vendosi: Fillimin e procedimit disiplinor ndaj {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Propozimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë së 1 vit”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c” dhe neni 108, i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar. Dërgimin e raportit të hetimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore pranë institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në seancën dëgjimore të datës 01.12.2021, të zhvilluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas njohjes me rrethanat faktike se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 478, datë 25.11.2021 ka vendosur “Shkarkimin nga detyra” të subjektit të rivlerësimit zotit Rexhep Kraraj, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat. KLGJ me vendimin nr. 559, datë 01.12.2021 vendosi: Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. Rexhep Kraraj deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 478, datë 25.11.2021 të KPK-së. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 660, datë 02.11.2023 vendosi: Shfuqizimin e vendimit nr. 559, datë 01.12.2021 të KLGJ-së për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të KPK-së; dhe vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}.

Nga informacioni i marrë në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit rezulton se ky institucion me vendimin nr. 14, datë 07.04.2023, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. 478, datë 25.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. {...}.

Neni 179/b, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë.

Neni 66, i ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: Vendimi i Kolegjit të Apelit që vendos shkarkimin nga detyra ka efekt të menjëhershëm “ex lege”.

Neni 164, i ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në dispozitat e tij kalimtare, parashikon se: Gjyqtarët dhe prokurorë në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj, vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 139, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: “1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: ... c. ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”; ...”.

Neni 134, pika 1, shkronja “ç”, i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, parashikon se: “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: ... ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji; ...”.

Neni 64, pika 1, shkronja “ç”, i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, parashikon se: “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ... ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; ...”.

Gjatë ecurisë së procedimit disiplinor ka rezultuar se gjyqtari {...} ka humbur statusin e magjistratit për shkak të aplikimit të masës disiplinore të “shkarkimit nga detyra” dhënë me vendimin nr. 478, datë 25.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, me vendimin nr. 14, datë 07.04.2023.

Ky sanksion i marrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, në kuptim të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 164, pika 1, shkronja “b” të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i

ndryshuar, dispozitat kalimtare të tij, passjell mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit.

Neni 95, i Kodit të Procedurës Administrative, parashikon se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”.

Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe në situatën faktike të parashtruar më sipër, kërkojmë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosë:

Përfundimin e procedimit disiplinor ndaj {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pa një vendim përfundimtar. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Fjala për ju zoti {...} për të parashtruar argumentet mbrojtëse.

{...}: Të them të drejtën, kur më erdhi njoftimi për këtë seancë isha me dy mendje, të vija apo mos të vij dhe zgjedha të vij, të vija jo për të mbrojtur këtë procedurë që i dihej përfundimi. Pra erdha për një gjë tjetër. T’ju shoh të gjithëve në sy, të gjithëve dhe t’ju them një gjë: Është shumë e rëndë, është shumë e rëndë t’i atribuosh tjetrit gjëra që nuk qëndrojnë; t’i atribuosh tjetrit të pavërteta. Kam pritur shumë nga kolegët e mi gjyqtarë, pjesë e kësaj trupe, kam pritur dhe me keqardhje konstatoj që asnjëri nga ju nuk ngjitet në nivelin që e kërkon ligji.

Ka rreth një vit që rropas, më fal, rropas në mendjen time çfarë jam? Çfarë jam unë? Çfarë jam unë?

Ilir Rusi: Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Të lutem tani. Ne këtu kemi ardhur për të diskutuar për procedimin. Nuk kemi ardhur këtu për... Në qoftë se ju thatë që s’keni gjë për të thënë për këtë, mendoj që është e tepërt që t’i futemi kësaj pjesës tjetër.

Ilir Rusi: Atëherë zoti {...}, sikundër ju jeni subjekt i këtij procedimi dhe i kësaj seance dëgjimore, ju lutem përmbajuni përcaktimeve ligjore për të parashtruar argumentet tuaja mbrojtëse për sa u parashtrua nga përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

{...}: Duke e marrë në konsideratë ndërhyrjen e zotit Hallunaj, e mbyll me kaq. Nuk do flas më. S'kam më gjë tjetër.

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të kësaj seance dëgjimore, ka pyetje apo diskutime nga ana e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor ndaj përfaqësueses së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj zotit {...}, apo edhe në mënyrë të ndërsjellët ndërmjet subjekteve të këtij procesi, që është përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe z. {...}, nëse ka pyetje apo diskutime.

Ilir Rusi: Meqenëse nuk keni pyetje apo diskutime, ftoj përfaqësuesen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...} dhe z. {...}, të largohen, me qëllim që Këshilli të vazhdojë me procesin e mëtejshëm të kësaj seance dëgjimore të këtij procedimi disiplinor.

Faleminderit për prezencën tuaj!

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së znj. {...}i dhe gjyqtari z. {...}.)

Ilir Rusi: Në vijim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, ftoj relatoren në lidhje me propozimet mbi vijueshmërinë e këtij procedimi disiplinor.

Fjala për ju zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Ashtu sikurse e citoi edhe përfaqësuesja e ILD-së, tashmë ish-gjyqtari {...} nuk e

gëzon më statusin e magjistratit për shkak se ai është shkarkuar me vendimin 478, datë 25.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 14, datë 07.04.2023.

Në kushtet kur ky ish-magjistrat nuk gëzon më statusin për shkak të të cilit edhe ishte proceduar nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, atëherë në referim të neneve 64, 134, 139 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë: Përfundimin e procedimit disiplinor ndaj z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat (në kohën e kryerjes së shkeljes), për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”. Ky është edhe propozimi im si relatore.

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime, po vazhdojmë në votimin e propozimit të relatores znj. Shehu.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim: “Për përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar.

2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Administrativ, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

(Rifutet në sallën e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}.)

Ilir Rusi: Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke marrë në konsideratë parashtrirat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe faktin që nga ana e z. {...} nuk u paraqit asnjë argument mbrojtës, pasi diskutoi, mori vendimin të cilin u bë me dije për publikun. Por në vijim të procedurës u thirr për t'iu komunikuar edhe palëve pjesë të këtij procedimi disiplinor, prezent në këtë moment është vetëm përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, znj. {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor mori këtë vendim:

Vendim: "Për përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar.

2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Administrativ, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

(Largohet nga salla e mbledhjes përfaqësuesja e ILD-së, znj. {...}.)

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit”. (Shtyrë nga mbledhja e datës 26.10.2023).²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e para sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte EWMI.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit”. (Shtyrë nga mbledhja e datës 26.10.2023).

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje plenare, vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për rindarjen me short të çështjeve gjyqësore”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Fjala për më tej relatores zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Në kushtet kur nga momenti kur kjo çështje u shty për një mbledhje tjetër, janë paraqitur disa komente, sugjerime nga disa Zëvendëskryetarë gjykatash, vlerësoj që kjo çështje duhet të kalojë për një mbledhje tjetër plenare, me qëllim që të rishikohet edhe një herë drafti, nën optikën e sugjerimeve që kanë dhënë edhe gjykatat.

Ilir Rusi: Ka ndonjë diskutim?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, vazhdojmë me votimin e propozimit të znj. Shehu.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë sipas propozimit, kjo pikë e këtij rendi dite shtyhet për t'u shqyrtuar në një mbledhje të ardhshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 80, datë 30.05.2019, “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta sipas rendit të ditës.

8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.*
4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 80, datë 30.05.2019, “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 80, datë 30.05.2019, “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe

Buxhetit. Kjo çështje do të relatohet nga Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, znj. Petriti.

Etrita Petriti: Përshëndetje të nderuar!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 08.11.2023, me vendimin nr. 673, miratoi detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2023, ku Këshillit të Lartë Gjyqësor i janë detajuar dhe miratuar 10 pozicione pune, si dhe numri total i pozicioneve të punës nga 128 për vitin 2022, ndryshon në 138 për vitin 2023.

Më konkretisht, për Këshillin e Lartë Gjyqësor, u miratuan pozicione pune si më poshtë:

Dy pozicione pune në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit, në Departamentin e Programimit dhe Administrimit të Buxhetit (më konkretisht): 1 pozicion pune Specialist Finance, në Sektorin e Financës; 1 pozicion pune Specialist Buxheti, në Sektorin e Buxhetit;

Gjithashtu edhe tetë pozicione pune, prej të cilëve 2 shef sektori dhe 6 specialistë, në Drejtorinë e IT-së dhe Menaxhimit të Çështjeve, në Departamentin e Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve, të cilat sjellin riorganizim të Drejtorisë së IT-së dhe Menaxhimit të Çështjeve, nga dy sektorë funksional, në katër sektorë të rinj me emërtesa, përbërje dhe detyra funksionale të ndryshme: Sektori i Menaxhimit të Sistemeve dhe Sportit të Gjykatave (1+4, një shef sektori dhe katër specialistë); Sektori i Projekteve dhe Zhvillimit (1+2, një shef sektori dhe dy specialistë); Sektori i Serverave dhe Infrastrukturës Mbështetëse (1+2, një shef sektori dhe dy specialistë); Sektori i Sigurisë së Informacionit, BCC dhe Back-up (1+2, një shef sektori dhe dy specialistë).

Për sa më sipër, propozojmë ndryshimin e vendimit nr. 80, datë 30.05.2019 të KLGJ-së, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar, duke pasqyruar pozicionet e punës të miratuara me vendimin nr. 637, datë 08.11.2023.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Unë nuk kam diskutime lidhur me përmbajtjen e aktit, por me mënyrën e formulimit të dispozitivit, se kërkoni të ndryshoni ndryshimin. Në fakt, në teknikën legjislativë, vendimi i Këshillit është një, është vendimi që ka miratuar strukturën, e ke me vendimin e vitit 18.01.2019 dhe ky vendim është ndryshuar me vendimin 30. Nuk ndryshohet ndryshimi. Vendimin 18.01.2019 e kemi të ndryshuar. Pra duhet të themi për një ndryshim të vendimit 12, datë 18.01.2019, i ndryshuar.

Nuk e di, më kuptuan anëtarët? Nuk bëhet ndryshimi i ndryshimit.

Në paragrafin e parë. Sepse thotë “1. Në vendimin nr. 80, datë 30.05.2019, “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019, i ndryshuar, të bëhet një ndryshim...”, pra ndryshohet ndryshimi. E kuptove?

Ndryshimi është në formulim. Domethënë, vendosi “Në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të ... Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar me vendimin nr. 80, datë 30.05.2019 (ose mund të mos e thuash fare ndryshimin), i ndryshuar, bëhet një ndryshim i cili është pjesë e lidhjes 1 dhe lidhjes 2”. Se mund të ndryshohet disa herë. Kjo është ideja.

Ilir Rusi: Po zonja Ukperaj, në vijim të diskutimeve tuaja.

Brikena Ukperaj: Në vijim të diskutimeve të mia, mendoj që titulli i projektvendimit të ndryshohet duke u specifikuar (të shënojë edhe Drejtoria Juridike): “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar”, dhe kjo gjë të reflektohet edhe tek pika 1: “Në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar, të bëhet një ndryshim në strukturën organizative të administratës, i cili është pasqyruar në Lidhjen nr. 1 dhe Lidhjen nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.”

Ilir Rusi: Ka diskutime në vijim të diskutimeve të zonjës Ukperaj?

Nuk ka diskutime. Atëherë vazhdojmë në votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Në vendimin nr. 12, datë 18.01.2019 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i ndryshuar, të bëhet një ndryshim në strukturën organizative të administratës, i cili është pasqyruar në Lidhjen nr. 1 dhe Lidhjen nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, Departamenti i Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, relatore znj. Yllka Rupa.⁴

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala, eksperte EWMI.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtim i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, relatore *znj. Yllka Rupa*.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, vazhdojmë me një pikë tjetër të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, me relatore *znj. Rupa*, i cili ka paraqitur edhe kundërshtime, por nuk është prezent sot në këtë mbledhje plenare.

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Rusi!

Të nderuar kolegë, në cilësinë e relatores, po paraqes projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}, periudha e vlerësimit është viti 2019.

Procedura e vlerësimit për këtë gjyqtar ka filluar me vendimin nr. 326, datë 14.06.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për vitin kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”. Procedura e plotë paraqitet

në projektraportin e vlerësimit i cili përmban gjithashtu edhe burimet e vlerësimit duke analizuar në mënyrë të hollësishme të dhënat që burojnë prej tyre.

Gjyqtarit i është njoftuar rezultati i vlerësimit. Ka shprehur mosdakordësi lidhur me nivelin e vlerësimit dhe pikëzimit të dy nënkritereve: përkatësisht për “Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes”, pasi është vlerësuar në nivelin mbi mesatar, duke u pikëzuar me 8 pikë nga 10 të mundshmet për shkak sepse në dosjet e vlerësuara mungonte letra e të drejtave e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personin nën hetim apo të dëmtuarin nga vepra penale e parashikuar në dispozitat përkatëse të Kodit të procedurës penale, si dhe për nëntreguesin tjetër “Publikimet ligjore dhe akademike” për të cilat ka mungesë të dhënash dhe për këtë arsye është vlerësuar me 0 pikë.

Kundërshtimet u janë komunikuar të gjithë anëtarëve të Këshillit në momentin e paraqitjes së tyre në rrugë elektronike nga relatori.

Kështu që në këto kushte unë do të paraqes në mënyrë të përmbledhur rezultatet e vlerësimit dhe të pikëzimit për gjithsecilin nga katër kriteret mbi bazën e të cilave vlerësohet gjyqtari.

Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, ky kriter vlerësohet mbi bazën e dy komponentëve njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor.

Lidhur me “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm”, propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë për këtë gjyqtar, pikëzimi 25 për arsye sepse në tërësi gjyqtari shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës të qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, duke i integruar dhe me një analizë të detajuar të provave. Evidentohet aftësia e tij në lidhje me identifikimin dhe përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material.

Në lidhje me “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Gjyqtari referon dhe interpreton dispozitat e ligjit material, duke i zbërthyer ato në funksion të dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e

çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i shtuar i gjyqtarit për identifikimin dhe zbatimin e praktikës relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të GJEDNJ. Gjithashtu, evidentohet kujdesi i shtuar i tij në referimin dhe zbatimin e parimeve të së drejtës. Për këtë arsye, për këtë nëntregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Për të kaluar tek “Arsyetimi ligjor”, lidhur me “Qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit në aktet procedurale të dosjeve të analizuara në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore është e qartë është e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme. Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës. Evidentohet në mënyrë të veçantë në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe. Propozohet lidhur me këtë nëntregues niveli i pikëzimit 15, niveli i vlerësimit shumë i lartë.

Në lidhje me “Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik”, në vendimet e analizuara evidentohet kujdesi i gjyqtarit për të nxjerrë në mënyrë të qartë thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën juridike në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i i vendimeve është i qartë dhe i plotë, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve në funksion të zgjidhjes së çështjes. Kështu që edhe në lidhje me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarit” propozohet të jetë 100 pikë, dhe niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në lidhje me “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, analizohen në aftësinë që ka gjyqtari për të përballuar ngarkesën në punë dhe për të kryer procedura gjyqësore.

Gjyqtari subjekt vlerësimi në lidhje me respektimin e afateve ligjore ka gjykuar në total 57 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 17 jashtë këtij afati. Në projektraportin e vlerësimit janë të analizuara në mënyrë të detajuar të 17 çështjet, bashkë me shkaqet e prezantuara nga gjyqtari, të cilat kanë çuar në zgjatjen e afatit dhe mos përfundimit të këtyre çështjeve brenda afatit.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (17 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon afat ligjor (57 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 29% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Sa më lart nga shpjegimet e gjyqtarit në formularin e vetëvlerësimit konstatohet se gjykimi i çështjeve jashtë afati ka ardhur për shkaqe të pavarura nga gjyqtari, si rezultat i ecurisë procedurale që kanë secila nga çështjet, siç janë kërkesa për shtyrje të prokurorit të seancës që të paraqesë në gjykatë kopje të vërtetuara të akteve, për shkak të heqjes dorë nga mbrojtja e avokatit të zgjedhur nga pala, apo kërkesa për shtyrje e mbrojtësve për t'u lenë kohë që të njihen me aktet e sjella në seancë nga prokurori.

Vërehet se nga vendimet burim vlerësimi, çështjet janë vënë në lëvizje gjithmonë brenda 1-3 ditëve pra për një kohe shumë të shkurtër dhe gjate gjithë kohës janë respektuar afatet për shtyrjet e seancave gjyqësorë duke u caktuar shumë afër. Nga një përlllogaritje matematikore për disa nga çështjet afati ligjore është tejkeluar nga 1-3 ditë çka nënkupton një tejkalim të papërfillshëm duke zbritur përqindjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afati nga 29% në 22%, e cila përkon sipas metodologjisë me 9 pikë.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e gjyqtarit lidhur me arsyet e shtyrjes, e zgjatjes së afateve ose edhe mendimin e kryetarit të gjykatës e cila shërben si burim vlerësimi, vlerësuar edhe në raport me përcaktimet e metodologjisë, kam vlerësuar dhe propozoj përpara Këshillit që në lidhje me këtë komponent gjyqtari të vlerësohet në kuotën e 15 pikëve, pra të ketë një vlerësim maksimal lidhur me këtë tregues.

Për të kaluar tek “Plotësimi i standardeve minimale kohore”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, përjashtuar një çështje e cila e përkthyer në përqindje përbën 7 % të çështjeve që janë në tejkalim të standardit që sipas metodologjisë vlerësohet me 5 pikë për gjyqtarin {...}.

Në lidhje me “Kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” ka rezultuar më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve, kështu që pikëzohet me 5 pikë.

Lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve, është rendimenti i përkthyer në përqindje sipas përcaktimit që parashikon ligji, rezulton të jetë 100%, kështu që propozohet niveli i vlerësimit maksimal lidhur me këtë komponent me 10 pikë.

“Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, ka rezultuar më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj gjyqtari pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues, me 15 pikë.

“Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore”, në lidhje me “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive”, referuar burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh sipas të dhënave nga statistikat duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, për treguesin “krime” është 13 seanca, për kategorinë “seanca paraprake” është 3 seanca, pra në total një mesatare me 8 seanca. Duke pasur parasysh shpjegimet e dhëna nga gjyqtari në formularin e vetëvlerësimit, rezulton se për kategorinë “krime”, numri mesatar i seancave nga përlllogaritja e bërë është 8 seanca dhe për kategorinë “seanca paraprake” është 3 seanca, por në total si mesatare për të dyja këto kategori rezulton të jetë në 6 seanca.

Pavarësisht numrit të lartë të seancave në çështjet e kategorisë “Klime”, duke marrë parasysh dhe vlerësuar të gjitha të dhënat që na rezultojnë nga burimet e vlerësimit, konstatohet se nga ana e gjyqtarit janë marrë të gjitha masat e nevojshme, për të zhvilluar dhe përfunduar procesin në kohë, si dhe janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme për zhvillimin e seancave efektive. Shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjykatës, por në funksion të shqyrtimit të çështjeve, konform një procesi të rregullt ligjor, në mënyrë që afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të mos bëhet shkak për cenimin e të drejtave procedurale të palëve në procesin gjyqësor. Kështu që në lidhje me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit për këtë gjyqtare me 15 pikë.

Për të kaluar tek “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në lidhje me këtë tregues, evidentuar kjo me korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes,

zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 20.

Në lidhje me “Aftësinë e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore”, referuar treguesit “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi me 5 pikë, pasi vërehet në të gjitha aktet burim vlerësimi dhe një aftësi shumë e mirë e gjyqtarit për këtë tregues.

Ndërsa lidhur me “Saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes”, treguesi tjetër ky, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruar në raportin analitik, evidentohet se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata në përputhje me veprimet procedurale të kryera, janë njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, vendimet gjyqësore si dhe aktet e paraqitura nga palët. Në përgjithësi nuk rezultojnë prani të dokumentacionit apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete në dosjet e vëzhguara, por rezulton se në dosjet burim vlerësimi nuk është e administruar “Letra e të drejtave”, e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale. Ndërkohë që komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a, 58, 140 paragrafi 1 dhe 137 i K.Pr.Penale. Vetëm në njërin nga dosjet burim vlerësimi konkretisht në një çështje me nr. 40 vendimi, ndodhet e administruar letra e të drejtave.

Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga nenet 34/a dhe 58 të K.Pr.Penale subjekteve i janë garantuar duke ju bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mosadministrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosjen gjyqësore, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

Në kundërshtimet lidhur me këtë tregues gjyqtari parashtron: Krahas faktit se të drejtat e parashikuara në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale subjekteve u janë garantuar nga ana ime si gjyqtar duke iu bërë me dije gjatë zhvillimit të gjykimit, sqaroj se letra e të drejtave u është dorëzuar të pandehurve dhe personave nën hetim që në

fazën e hetimit paraprak, fakt që e kam verifikuar që në momentin që jam njohur me dosjen dhe për këtë arsye kam vlerësuar se ky veprim procedural tashmë është kryer, duke mbajtur parasysh edhe faktin e rëndësishëm se këto të drejta nuk kishin pasur ndonjë ndryshim që nga faza e hetimit paraprak, pasi dispozitat e K.Pr.Penale që parashikojnë të drejtat e të pandehurve nuk kanë ndryshuar që nga koha e miratimit të tyre në vitin 2017 deri në momentin kur unë gjykoj këtë çështje. Nga ana tjetër vlerësoj se nenet e sipërcituar janë dispozita që parashikojnë njoftimin e të drejtave të pandehurit, personit nën hetim apo viktimës, i është dorëzuar një herë më parë letra e të drejtave, për më tepër ato nuk specifikojnë shprehimisht që marrja në pyetje për herë të parë apo njoftimi për herë të parë duhet konsideruar veçmas për çdo fazë të çështjes penale.

Gjyqtari citon edhe situatën tjetër kur neni 34, paragrafi “a” pika 2 K.Pr.Penale parashikon dorëzimin e letrës së të drejtave të pandehurit ose personit nën hetim përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme sipas ligjit, duke theksuar se prania e tyre në seanca gjyqësore ose seancat paraprake nuk kanë qenë të detyrueshme në asnjë nga seancat e gjykimeve ku janë dhënë vendimet. Gjyqtari citon gjithashtu edhe vendimet dhe shpjegon se në asnjë nga vendimet e dhëna nuk ka qenë prezent situata ligjore e parashikuar në nenin 353 të K.Pr.Penale ku kërkohet e detyrueshme prania e të pandehurit në gjykim.

Lidhur me sa parashtron gjyqtari, Këshilli tashmë ka mbajtur qëndrimin lidhur me këtë aspekt procedural, mungesa e të cilit, për sa i përket pikërisht letrës së të drejtave, vlerësohet si mangësi në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes. Nëpërmjet parashikimit të nenit 34 të K.Pr.Penale, legjislatori ka synuar vendosjen e standardeve ndërkombëtare të parashikuar në direktivat e vitit 2013 të Bashkimit Evropian dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat e të pandehurit dhe personit nën hetim, të mbrojtjes gjithashtu dhe mbrojtjes së të pandehurit të personit, pra të parashikuara edhe nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjyqtari si subjekt me cilësinë e organit procedues përgjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes ka detyrimin të njoftojë menjëherë dhe në mënyrë të detajuar subjektet në procedim, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe të rregullt ligjor pavarësisht se ky aspekt mund të jetë ezauruar ose jo nga organet proceduese të fazave pararendëse procedurale,

në mënyrë që ndaj të pandehurit të përmbushet plotësisht garancia për një proces të drejtë. Ligji, ka parashikuar organin procedues, pra dhe gjyqtari në fazën përkatëse procedurale si autoritetin përgjegjës për njoftimin e “Letrës së të drejtave”, çka do të thotë se veprimet e parashikuara në nenin 34, paragrafi a të Kodit, kryhen sipas rastit dhe nga gjyqtari. Mosrespektimi nga organi procedues i këtij detyrimi, pra i njohjes paraprakisht i të pandehurit me të drejtat e tij nëpërmjet “Letrës së të drejtave” është vlerësuar nga Këshilli si mangësi në aspektin e plotësisë së dokumentacionit të dosjes dhe si e tillë evidentohet edhe reflekton në nivelin e pikëzimit dhe të vlerësimit lidhur me këto tregues. Kështu që, në këto kushte unë propozoj që niveli i vlerësimit lidhur me këto tregues për gjyqtarin {...} të jetë në nivelin mbi mesatar, pikëzimi 8 pikë.

Në lidhje me propozimin, për nivelin e vlerësimit sa i takon kriterit “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, propozohen pikët 98, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Për të kaluar te “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit”, për të gjithë komponentët e këtij kriteri propozohet niveli maksimal i vlerësimit dhe i pikëzimit, për arsye sepse gjyqtari shfaq angazhim dhe përgjegjshmëri të lartë në funksion, ka integritet, nuk përdor gjuhë diskriminuese dhe për këtë arsye propozohet niveli “Shkëlqyeshëm”, pikët 100, pra në lidhje me kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”.

Lidhur me, “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional të gjyqtarit”, “Aftësia e komunikimit”, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent dhe i kuptueshëm, kështu që, i propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, gjithashtu propozohet të jetë niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikëzimi 15, për arsye sepse gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale për palët dhe subjektet për të cilat është vënë në dijeni.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, gjithashtu është vlerësuar në të dy nëntreguesit në nivelin shumë të lartë, pikëzimi maksimal 15 dhe 10 pikë, për arsyen sepse shfaq nivel shumë të mirë komunikimi dhe bashkëpunimi me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me to, gjithashtu edhe një nivel shumë të mirë

komunikimi me administratën gjyqësore.

Në lidhje me, “Gatishmërinë e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në trajnime të tjera, është vlerësuar në nivelin e 20 pikëve sepse ka të dhëna që gjatë vitit 2019 ka marrë pjesë në 8 aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës.

Në lidhje me “Disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjithashtu propozohet niveli i pikëzimit me 5 pikë sepse ka të dhëna që provojnë një fakt të tillë.

“Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtarinë ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykatat”, vlerësohet në nivelin e 5 pikëve, për arsye sepse gjyqtari subjekt vlerësimi rezultoi të ketë paraqitur një vërtetim me nr. 674, paragrafi i parë, datë 25.07.2023 lëshuar nga burimet njerëzore të Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, ku provohet të ketë ushtruar mësimdhënie në ciklin Bachelor, në ciklin Master Profesional. Për këtë arsye, është vlerësuar me 5 pikë.

Lidhur me “Publikimet ligjore dhe akademike”, është vlerësuar me 0 pikë, për arsye sepse nuk paraqiten të dhëna, nuk ka të dhëna lidhur me vlerësimin e këtij treguesi. Në kundërshtimet e tij gjyqtari z. {...} ka paraqitur një vërtetim të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës datë 06.11.2023, përmbajtja e të cilit (ju duhet të jeni njohur besoj me këtë akt), pra: “Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar në rrugë elektronike në adresën e e-mailit, protokolluar në Shkollën e Magjistraturës ku ju kërkon informacion mbi publikimet e punimeve tuaja të paraqitura pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin 2019, ju informojmë se Shkolla e Magjistraturës në vitin 2019, ka publikuar në faqen zyrtare të saj, në kuadër të programit të formimit vazhdues, punimin e paraqitur nga ana juaj me temë “Mbrojtja e të drejtave të të miturit dëshmitar”, Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur.”. Siç konstatohet nga përmbajtja e këtij akti është një publikim në kuadër të formimit vazhdues, pra në kuadër të pjesëmarrjes së gjyqtarit në programet e formimit vazhdues, kontribut i cili është vlerësuar tek komponenti përkatës, kështu që nuk e shoh apo vlerësoj këtë të drejtë ose të arsyeshëm që ky punim të vlerësohet dy herë, pra dhe në kuadër të publikimeve ligjore dhe akademike.

Kështu që, niveli, në cilësinë e relatores propozoj që, lidhur me këtë tregues, “Publikimet ligjore dhe akademike”, të mos vlerësohet gjyqtari, pra të ketë 0 pikë, për arsye se nuk provohen, pra nuk ka akte që provojnë një gjë të tillë. Kështu që, lidhur me kriterin “Aftësitë personale dhe angazhime profesional”, për gjyqtarin {...}, propozoj nivelin e pikëzimit 95, nivelin e vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Në mënyrë të përmbledhur niveli i përgjithshëm i vlerësimit dhe për gjithsecilin kriter është i tillë: “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", “Aftësitë organizative”, 98, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional”, pikët 95, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Niveli i përgjithshëm i vlerësimit për gjyqtarin është "Shkëlqyeshëm", pikët 393.

Faleminderit për vëmendjen!

Ilir Rusi: Faleminderit, zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Po z. Kurushi, fjala për ju!

Klodian Kurushi: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Atëherë, në lidhje me ralatimin e bërë dhe propozimet e bërë nga relatorja, unë fillimisht gjej rastin, konfirmoj pothuajse plotësisht me bindje, projektraportin e përgatitur dhe propozuar dhe dakordësohem me pjesën më të madhe të përfundimeve të arritura dhe propozimeve që relatorja bën në mbledhjen e sotme mbi vlerësimin e gjyqtarit z. {...}, me përjashtim të një treguesi që i referohet rastit të treguesit të “Saktësisë dhe plotësisë së dosjes”, së dokumentacionit të dosjes, ku propozimi është mbi mesataren (8), unë do të thosha në këtë rast që propozimi për gjyqtarin në këtë rast të jetë në nivelin shumë të lartë, me 10 pikë.

Pse e bëj këtë propozim?

Ne shikojmë që, në burimet e vlerësimit për z. {...} janë marrë gjithsej 6 (gjashtë) dosje të përzgjedhura me short, ndërkohë 2 (dy) dosjet tjera i ka përzgjedhur vetë z. {...}

për t'i sjellë si pjesë e dosjeve të përzgjedhura të trajtuara prej tij në vitin 2019. Pra, po themi, përzgjedhja e dosjeve është 6 (gjashtë), nga të cilat, për fat të mirë ose të keq, 3 (tre) dosje i përkasin situatave që nuk lidhen drejtpërdrejt me “Letrën e të drejtave”, 2 (dy) prej të cilave janë kërkesa për “zëvendësim mase sigurimi” dhe “revokim mase sigurimi” dhe 3 (tre) të tjera janë kërkesa që shqyrtohen nga gjyqtari i seancës paraprake, që janë trajtuar nga gjyqtari i seancës paraprake në vitin 2019, në këto 3 (tre) dosje, ku normalisht duhet të komunikohet “Letrën e të drejtave”, një nga këto 3 (tre) dosje është bërë komunikimi i “Letrës së të drejtave”, është e cituar, ndërsa 2 (dy) të tjerat nuk është bërë komunikimi i “Letrës së të drejtave”. Arsyeja pse është bërë lidhet me faktin se, një nga të pandehurit në këtë proces gjyqësor nuk ka qenë i pranishëm, dhe njoftimi për këtë të pandehur është bërë referuar nenit 140, të Kodit të Procedurës Penale, ku përtej njoftimit ai shoqërohej dhe me “Letrën e të drejtave”, dhe realisht nuk ka ndodhur. E njëjta situatë paraqitet edhe në 2 (dy) dosjet e tjera që i ka ofruar vetë zoti {...}. Në këto dy dosje, njëra nga këto dosje rezulton që është letra e të drejtave sepse ndodhemi në njëjtën situatë ku i është bërë njoftimi, i është bërë komunikimi i të pandehurve në mungesë mbi “Letrën e të drejtave”, ndërkohë për dosjen tjetër nuk ekziston. Pra, në rrethin e përgjithshëm të çështjeve, që janë të tilla, nuk ndodh që z.{...} në të gjitha rastet nuk e ka aplikuar ose nuk e ka zbatuar atë kriter ligjor që referohet saktësisë së plotësisht të dokumentacionit të dosjes, në disa ka ndodhur dhe në disa të tjera nuk ka ndodhur.

Kështu që, në këtë pikë, unë mendoj, referuar edhe pjesës së përzgjedhjes së dosjeve sepse nuk i kemi marrë të gjitha dosjet e zotit... (s'mund t'i marrim), thashë ato pjesë të dosjes që ne i kemi marrë, ai edhe i ka në një pjesë edhe nuk ka në një pjesë tjetër, -kjo është e para.

Dhe e dyta, referuar faktit që bëhet fjalë për vitin 2019, ku gjyqtari i seancës paraprake (këto çështje u morën për t'u vlerësuar mbi “Letrën e të drejtave”), gjyqtari i seancës paraprake në atë kohë, para ndryshimeve legjislativitetit, nuk gjykonte në themel siç mund të gjykojë sot, në rastin e shqyrtimit të kërkesave për gjykim të shkurtuar. Ndodhur pikërisht në këtë situatë unë mendoj që, jo tamam plotësisht, po në një pjesë të dosjeve, z.{...} e ka përmbushur atë detyrim që rrjedh nga ligji “Për statusin” mbi kriteret e vlerësimit të tij. Referuar kësaj situatë që unë përmend mendoj dhe bëj propozimin

shtesë, që në këtë rast, ka mundësi që për këtë tregues, t'i shtohen edhe 2 pikë, dhe nga niveli mbi mesatar të jetë në nivelin shumë mirë, duke i shtuar nga 8 pikë që bën propozimin relatorja në 10 pikë në total. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit z.Kurushi!

Po znj.Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Jo se jam në kundërshtim me z.Kurushi por dua të saktësoj diçka.

E kam thënë dhe herë tjetër, këtu nuk vlerësohet gjyqtari për kryerjen apo jo të komunikimit të “Letrës së të drejtave”, pra për veprimin procedural, vlerësohet për saktësinë e dokumentacionit që ka në dosje. Pra, gjyqtari mund ta ketë kryer si veprim procedural, por në dosje nuk ka, aq më tepër lind dyshimi kur ca dosje kanë dhe ca dosje nuk kanë. Ne nuk mund t'i futemi gjithë procedurës, ka qenë i pandehuri s'ka qenë i pandehuri, ishte i shkurtuar, i zakonshëm. Dhe një arsye tjetër, vetë z.{...} në kundërshtimet e tij, pranon këtë fakt (unë po lexoj çfarë ka thënë z.{...}), thotë, shkruan se çfarë i ka gjetur relatorja dhe pastaj thotë: “Krahas faktit se të drejtat e parashikuar nga neni 34/a dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale, subjekteve u janë garantuar nga ana ime si gjyqtar duke iu bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit sqaroj se (dhe sqaron): “Letra e të drejtave”, u është dorëzuar të pandehurve dhe personave nën hetim që në fazën e hetimit paraprak, fakt që e kam verifikuar në momentin që jam njohur me dosjen dhe për këtë arsye kam vlerësuar se ky veprim procedural tashmë ishte kryer”, -pra vetë ai ka konsideruar që “Letra e të drejtave”, është mjaftuar me atë të hetimit paraprak, gjetje, për të cilën ne zonjën {...} dhe disa gjyqtarë të tjerë, në fakt, nuk ia pranuan si justifikim. “Këtu kam mbajtur parasysh (thotë) edhe faktin e rëndësishëm se këto të drejta nuk kishin pësuar ndonjë ndryshim nga faza e hetimit paraprak...”.

(I përgjigjet zotit Kurushi) Nuk ka lidhje me këtë që thua ti, ka lidhje me këtë që kundërshton z.{...}.

Sepse ju te znj. {...} i bëtë dhe pyetjen: Pse ju nuk e komunikoni përsëri “Letrën e të drejtave”, duke qenë në fazën e hetimit paraprak? Dhe ajo mbeti dhe tha: - Jo, është një

veprim që duhet për të gjithë sepse organ procedues është....

Klodian Kurushi: Në këtë rast ky e ka komunikuar një herë.

Brikena Ukperaj: Këtë gjë thotë dhe z.{...} në konkluzionet, thotë: “Letra e të drejtave”, u është dorëzuar që në fazën e hetimit. E kam verifikuar dhe nuk kam patur...”

(Zoti Kurushi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brikena Ukperaj: Të lutem, ky thotë qëndrimin e tij që mban, se gjyqtari nuk mund të mbajë qëndrime të ndryshme në dosje të ndryshme, qëndrimin që gjyqtari mban në rastet kur, “Letra e të drejtave”, është komunikuar në hetimet paraprake. Ky ka këtë qëndrim dhe thotë: “Kështu kam mbajtur parasysh dhe faktin e rëndësishëm që të drejtat nuk kishin pësuar ndryshim nga faza e hetimit paraprak, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që parashikon të drejtat e të pandehurit nuk kanë ndryshuar që nga koha e vitit 2017 dhe deri në kohën e gjykimit kur ka përfunduar këto çështje”.

Tani dosjet që ne përzgjedhim me short Klodi, janë dosje (ne nuk mund t'i marrim të gjitha dosjet), janë kampione në të cilat ti shikon treguesit e gjyqtarit për të gjitha indikatorët e ligjit.

Tani, në kushtet kur vetë gjyqtari pranon faktin që, kur “Letrën e të drejtave”, e kam në hetimin paraprak, ku nuk e ndryshoj sepse nuk ka ndryshuar ligji të drejtave e të pandehurit deri në vitin 2017, nuk mundemi dot të arrijmë në konkluzionin që e bën për të gjitha çështjet sepse dhe vetë gjyqtari e pranon që nuk e bën për të gjitha çështjet.

Edhe diçka tjetër, edhe një herë them, ne nuk e vlerësojmë gjyqtarin në këtë rast për kryerjen si veprim të “letrës”, por e vlerësojmë për administrim të saktë të procesit, kaq.

Ilir Rusi: Po z.Kurushi!

Klodian Kurushi: Kam përshtypjen që nuk u kuptova në atë çfarë thashë.

Në 3 (tre) situata, në 3 (tre) dosjet, të cilat i referohen fazës së seancës paraprake,

përmenda me saktësi dhe thashë: “Për 1 (një) dosje ekziston “Letra e të drejtave”, për 2 (dy) të tjerat nuk ekziston “Letra e të drejtave”.

Dhe pse ka ndodhur kjo?

Një pjesë e shpjegimeve qenka dhënë nga z. {...}. Ndërkohë, unë them, për një rast ku i pandehuri ishte në mungesë, referuar nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari ia ka njoftuar “Letrën e të drejtave”. Ndërsa për 2 (dy) raste të tjera ku gjyqtari e ka konstatuar që i pandehuri ka qenë i pranishëm në seancë, është marrë konfirmimi i njoftimit të “Letrës së të drejtave”, nga gjyqtari që ka caktuar masën e sigurimit ose nga prokuroria në fazën e hetimeve paraprake, kur ka bërë pyetjen për herë të parë apo kur është arrestuar nga policia gjyqësore.

Këtë dua të ndaj unë si situatë. Pra gjyqtari në disa raste e bën sepse referon në nenin 140 të Kodit të Procedurës Penale, si një detyrim ligjor për t’ia njoftuar “Letrën e të drejtave” të pandehurit në mungesë, ndërsa në disa raste të tjera, për të cilat edhe unë dakordësohem (siç ishte rasti i znj. {...}), kur i pandehuri ka qenë i pranishëm, ai nuk e ka komunikuar “Letrën e të drejtave”, duke marrë në konsideratë faktin që kjo “Letër e të drejtave”, ndodhet në dosje. Për këto 2 (dy) të tjerat dakordësohem me ju, por pjesa tjetër është një situatë e re, e padiskutuar nga ne përpara, dhe i referohet nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale.

Brikena Ukperaj: Nëse, do dakordësohemi se gjyqtari në disa raste komunikon, këtë që sapo thatë, “Letrën e drejtave”, dhe në disa raste të tjera nuk e bën sepse merr parasysh atë të prokurorisë, atëherë këtu jemi në indikator tjetër, jemi në “ai s’kryen të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit. Relatorja, e ka vlerësuar maksimalisht këtu. Bëhet fjalë vetëm për administrim procesi.

Klodian Kurushi: Jo, jo. Hajde ta gjejmë këtë pjesën.

Nuk është kështu.

E para njëherë duhet të diskutojmë se kush është organ procedues (neni 34, 34 /a); sa herë komunikohen “Letrat e të drejtave”.

Brikena Ukperaj: Një herë e komunikon gjykata.

Sa herë e komunikon?

Klodian Kurushi: S'është një herë pra. Nuk është diskutuar.

Në çdo fazë ku ndodhemi.

Brikena Ukperaj: Sa herë që njofton të pandehurin komunikon "letrën"?

Klodian Kurushi: Në çdo fazë ku ndodhemi, kur thotë Kodi i Procedurës Penale, (34/ a, 34 /b), se ky është diskutimi që po bëjmë.

Ilir Rusi: Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Më fal, diskutimi është... nuk po diskutohet fakti në rast se e ka kryer apo jo sepse po të diskutojmë faktin që ai i ka kryer, ai është vlerësuar maksimalisht për kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme. Por këtu është për plotësinë e dokumentacionit, ato çfarë janë në dosje, si janë administruar në dosje, dhe ne për sa i përket vitit 2019, ne i kemi vlerësuar dhe disa gjyqtarë të tjerë, të cilët janë pikëzuar me 8 pikë, për shkak... të njëjtin pretendim kanë pasur në kundërshtime.

(Zoti Kurushi flet pa ndezur mikrofonin.)

Irena Plaku: Të njëjtin kundërshtim kanë pasur.

Unë po them çfarë kemi vlerësuar neve.

Ilir Rusi: Ka propozime të tjera në vijim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës?

(Nuk ka diskutime të tjera.)

Meqenëse nuk ka diskutime të tjera, po vazhdojmë me hedhjen në votë propozimin e zotit Kurushi, në lidhje me "Saktësinë e plotësisë të dokumentacionit të

dosjes” një vlerësim nga 8 në 10 pikë, duke u shtuar 2 pikë në eventualitet të votimit përkatës. Vazhdojmë me votimin.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord, me arsyetimin se rezulton, nuk është si rastet e tjera, rezulton që “Letra e të drejtave” është e pasqyruar në dosje, të paktën pjesërisht. Faleminderit!

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Miratohet propozimi i z.Kurushi.

(7 vota pro dhe 3 vota kundër. Miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Atëherë vazhdojmë në votimin në tërësi të projektvlerësimin përkatës, duke reflektuar dhe ndryshimet që ndodhën për shkak të këtij propozimi dhe votimit.

Fatmira Luli: Kam dhe unë një propozim lidhur me ankimin që ka bërë për “Publikimet ligjore akademike”, i cili është vlerësuar {...} me 0 pikë.

Ilir Rusi: Në vijim, meqenëse u parashtrua fakti nëse ka diskutime apo jo në lidhje me propozimet dhe relatimin e znj. Rupa.

Patjetër që po, atëherë, nuk do kalohet te votimi në tërësi të projekt-aktit për shkak se znj.Luli reflektoi dhe pas fjalës time nëse ka diskutime apo jo, tashmë reflekton dhe gjykon që ka diskutime të tjera.

Fjala për ju znj.Luli!

Fatmira Luli: Sa parashtrova lidhur me këtë tregues, gjyqtari ka paraqitur botimin që ka bërë Shkolla e Magjistraturës me temën “Mbrojtja e të drejtave të të miturve dëshmitarë”, dhe për këtë ka sjellë dokumentacionin përkatës. Revista e shkollës, konsiderohet një revistë shkencore dhe botimet që janë quhen botime akademike për shkak të nivelit të lartë për të cilën ato shërbejnë në procesin e trajnimit vazhdues. Në këto kushte, gjykoj që duhet të merrte dhe 5 pikë të mundeshe në pikën “Publikimet ligjore dhe akademike”.

Yllka Rupa: Mund të sqaroj pak?

Ilir Rusi: Faleminderit znj.Luli!

Fjala për relatoren znj.Rupa.

Yllka Rupa: Publikimi nuk rezulton të jetë botuar në revistën juridike të shkollës, pra thjesht është prezantuar tek faqja e shkollës me të gjithë aktivitetin që i dedikohet temës, në të cilën rezulton që gjyqtari ka marrë pjesë.

Atëherë duhet të biem dakord se çfarë konsiderohet publikim akademik dhe ligjor. Pra, janë publikime në revista kombëtare ose ndërkombëtare që kanë numër identifikimi ose kombëtar ose ndërkombëtar. Kështu që, unë mendoj që ky shkrim, ky publikim nuk hyn në kategorinë e publikimeve ligjore dhe akademike.

Ilir Rusi: Fjala për ju znj. Plaku!

Irena Plaku: Atëherë, sipas metodologjisë, për të pasur, për të konsideruar një publikim, duhet një publikim ligjor akademik të publikuar në revistën shkencore, që janë me ISBN dhe ISSN. Nga verifikimi, po të shikosh te faqja e Shkollës së Magjistraturës, në revistën e vitit 2019, sepse duhet të jetë publikuar në të njëjtin vit, periudhë vlerësimi, jo kur është çuar për botim, nuk është botuar asnjë publikim i z.{...} (siç e ka relatuar). Gjithsesi, në rast se do kishte një publikim të tillë, duhet të sillte dhe faqen e revistës, por nuk e ka sjellë këtë gjë. Por thotë, që është vetëm një publikim në kuadër të atë që ka

çuar, duke qenë si ekspert. Të gjithë ekspertët dhe lehtësuesit çojnë materiale dhe nuk është publikim që është publikuar në faqen... nuk është publikim me ISBN dhe ISN.

(Zonja Luli flet pa ndezur mikrofonin.)

Fatmira Luli: Botimi është ezauruar... Pastaj është vënë në bibliotekën e shkollës dhe ai është proces që vazhdon sipas radhës që kanë temat që do pasqyrojnë gazetën e shkollës. Kështu që, ai e ka bërë.

Irena Plaku: Nuk është kjo. Ne kemi konsideruar publikim ligjor vetëm atë publikim që është miratuar në revistën shkencore, në një revistë si e magistraturës apo çdo revistë shkencore, të publikuar në vitin përkatës. Që të kemi një publikim, në radhë të parë, duhet të kalojë dhe nga një bord nëse janë kushtet për t'u publikuar ose jo?

Fakti që, ai nuk është botuar, (unë po të them që nuk është botuar, vetëm kaq më mjafton mua), për sa kohë që nuk është botuar në atë vit, nuk është publikuar në revistë shkencore.

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera?

Atëherë, për sa i përket "Publikimeve ligjore akademike", znj.Luli propozon që vlerësimi të jetë me një shtesë prej 5 pikësh, apo jo znj.Luli?

Fatmira Luli: Po!

Ilir Rusi: Dakord.

Nga zero të shkojë në 5 pikë.

Vazhdojmë më votimin e propozimit të znj.Luli.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër. Dakord me argumentet e relatores dhe parafolëses.

Faleminderit!

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

(Nuk miratohet propozimi.)

Ilir Rusi: Atëherë në lidhje me këtë projektvlerësim, do të reflektohen ndryshime vetëm në lidhje me miratimin e propozimit të z.Kurushi.

Kështu, që hedhim në votim në tërësi të këtij projektvendimi, duke reflektuar ndryshimet përkatëse.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore znj. Brikena Ukperaj.⁵

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare)* |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e katërta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicantaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte EWMI.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore *znj. Brikena Ukperaj*.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, për të cilin është përgatitur relacioni, me relatore *znj. Ukperaj*.

Fjala për ju *znj. Ukperaj*.

Brikena Ukperaj: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Gjyqtarja, {...} është vlerësuar për përudhën 2013 – 2016 me qëllim gradimin e saj, pas dërgimit të dosjes me aktet e vlerësimit profesional në organet e rivlerësimit.

Gjyqtarja është njohur me projektraportin e vlerësimit dhe nuk ka paraqitur

kundërshtime, nuk ka paraqitur kërkesë për prova të reja.

Në pjesën e parë shpjegohet procedura. Në pjesën e dytë shpjegohen të gjitha burimet e vlerësimit me përshkrimet e dosjeve. Janë marrë gjithashtu të dhëna nga ish-Inspektorati i KLD, lidhur me trajtimin e ankesave. Në këtë rast, dua të theksoj që nga tërësia e ankesave që i janë trajtuar gjyqtares, 2 (dy) verifikime, 2 (dy) ankesa janë përcjellë organit vlerësues, në atë kohë ka qenë ish-Inspektori, por nuk është bërë vlerësimi. Kështu që, i bie që duhet patjetër t'i marrim parasysh në gradim, për efekt të vlerësimit etik profesional por, si e dhënë statistikore, duke marrë parasysh ndryshimet që ka pasur sistemi i vlerësimeve më përpara, thjesht përqindja matematikore e të dhënave statistikore pikëzohej, ndërsa aktualisht përqindja e të dhënave matematikore për efekt të standardit minimal të afatit, i nënshtrohet dhe analizës logjike. Janë analizuar nga ana ime si relatore të gjitha këto gjetje në projektraportin e vlerësimit.

Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, është vlerësuar maksimalisht me 100 pikë për kriterin e aftësive profesionale, në të gjithë treguesit e këtij treguesi lidhur me: “Aftësinë e gjyqtares për të identifikuar faktet e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave”, ka rezultuar se ajo ka aftësi shumë të lartë për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale ashtu dhe atyre thelbësore, të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar të plotë dhe analitike, duke integruar me provat e administruara në gjykim dhe faktin ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit të tyre.

Ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës, normave konkrete procedurale ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e tyre lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjes e cila shërben si bazë për orientimin e analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Lidhur me, “Interpretimin e ligjit të zbatueshëm”, të gjitha vendimet gjyqësore gjejnë të interpretuar ligjin material apo atë procedural, paraprakisht se gjyqtari t'i japë përgjigje mënyrës së zgjidhjes së konfliktit.

Ka kujdes të shtuar për identifikimin e praktikës gjyqësore unifikuese, të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese si dhe referon dhe zbaton parimet e së drejtës në aspektin procedural dhe atë thelbësor. Vendimet gjyqësore janë të qarta, koncize, janë të

kuptueshme kryesisht në pjesën e analizës ku gjyqtarja me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, të pangarkuar nga terminologjia teknike, i jep përgjigje të gjitha pretendimeve apo prapësimeve të ngritura nga palët në gjykim.

Ka një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit të ndërtuar mbi rrjedhë logjike. Ka një cilësi shumë të lartë të analizës dhe argumentimit logjik, duke ndjekur rregullin fakt, normë, interpretim, konkluzion. Krijohet një pamje e qartë e zhvillimit të mendimit juridik në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin mendim të analizuar mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështet në interpretimin e ligjit, pasurohet me qëndrimin e praktikës, arsytimi është i qartë dhe i plotë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve për çështjet e shtruara për diskutim, me qëllim që të japë një përgjigje të argumentuar lidhur me zgjidhjes e çështjes. Aftësia shumë e lartë, pikët 25.

Në total për kriterin e parë të “Aftësive profesionale”, niveli i vlerësimit, “Shkëlqyeshëm” pikët 100.

Për sa i përket “Aftësive organizative”, “Respektimit të afateve ligjore”, ka rezultuar nga burimet e vlerësimit vetëm një çështje e shqyrtuar tej afatit 20-ditor të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile, ka qenë shtyrja e afatit ekzekutimit të vendimit në të holla. Çështja në fakt ka qenë komplekse, por duke qenë se ka pasur vetëm dy çështje me afat ligjor, vetëm kjo çështje përkon me 50 % të çështjeve të shqyrtuara e cila përkon me nivelin e vlerësimit 3 pikë. Megjithatë, përveç analizës matematike, vlerësuesi duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke konsideruar: natyrën e çështjes, e cila për edhe pse për mënyrën se si investon gjykatën bëhet nëpërmjet mjetit procedural “kërkesë”, ajo detyron gjykatën për dëgjimin e kreditorit, çka do të thotë që çështja nuk mund të shqyrtohej sipas ligjit procedural të kohës në dhomë këshillimi, por në seancë gjyqësore, duke i dhënë mundësi edhe kreditorit “person i tretë” të paraqesë prova në gjykim, të cilat rezultojnë të jenë administruar e analizuar nga gjyqtarja; masën e tejkalimit të afatit me 1 muaj e 7 ditë; pamundësinë për të analizuar e gjykuar mbi veprimet e ndërmarra nga gjyqtarja për administrimin e çështjes, pasi vendimi ka qenë një vendim i përzgjedhur prej saj, por ndërkohë mbi bazën e shpjegimeve të dhëna prej saj gjatë procesit të rivlerësimit

kalimtar, vetë organet e rivlerësimit kanë konsideruar se kjo çështje duhej të konsiderohej e gjykuar brenda afatit pa bërë dallimin e afatit ligjor me standardin minimal, pra e kanë trajtuar çështjen për shkak të natyrës jo si çështje me afat ligjor, vlerësoj se vetëm një çështje nuk mund të mund të shërbejë si përcaktuese e shkallës së aftësisë së lidhur me këtë tregues. Për këtë arsye kam vlerësuar pikëzimin me 15 pikë për këtë treguesin e “Respektimit të afateve ligjore”.

Lidhur me, “Respektimin e standardit minimal”, tani në këtë tregues janë marrë parasysh, janë analizuar të gjitha dosjet e dërguara nga organet e rivlerësimit, dosjet e përzgjedhura me short dhe të gjitha të dhënat e përcjella nga ish-Inspektorati pranë KLD-së lidhur me dy dosjet që i janë referuar gjyqtarës si e dhënë statistikore lidhur me vlerësimin etik dhe profesional, pra si dosje të referuara si zvarritje gjykimi.

Pasi janë analizuar të gjitha dosjet, në tërësi kam vlerësuar se duke marrë parasysh: raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve (që kanë rezultuar në masën 42.8%); faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarës por që lidhen me ecurinë e procesit, respektimin e të drejtave të palëve, etj. (fakt i cili është konstatuar dhe gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, gjyqtarja ka dhënë shpjegime të hollësishme gjatë këtij procesi, edhe nga inspektorët e KLD-së, ku kanë theksuar se në të gjitha rastet gjyqtarja nuk është bërë pengesë apo nuk ka shkaktuar ajo zvarritjen e procesit); treguesin sasior të punës gjatë së cilës gjyqtarja ka përfunduar 1452 vendime nga të cilat 580 çështje kanë qenë themeli, duke e kaluar standardin minimal sasior me “jo më pak se 360 çështje” me më shumë se 61%; natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësuesit është me e gjerë se treguesi i “Respektimit të afateve ligjore”; analizën jo vetëm matematikore, por edhe logjike të të dhënave statistikore, nga ka rezultuar se jo vetëm gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, por edhe gjatë procesit të hetimit disiplinor për njërin nga çështjet si dhe gjatë analizës së të gjitha dosjeve burim vlerësimi, se zgjatja e gjykimeve kryesisht në dy prej çështjeve civile të analizuara më lart, nuk ka ardhur për shkaqe që lidhen me mënyrën e menaxhimit të çështjes nga ana e gjyqtarës, por me nevojshmërinë e kryerjes së veprimeve procedurale; pamundësinë objektive për të lënë zhvillimin e seancave

përgatitore dhe atyre gjyqësore në një kohë më të afërt nga seanca paraardhëse, për shkak të natyrës së veprimit procedural si dhe ngarkesës totale në punë të; duke e pikëzuar maksimalisht gjyqtaren bazuar në nenin 93 pika 2 e Ligjit “Për statusin”, sipas të cilit aftësia e gjyqtarit lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve duhet të analizohet sipas situatës, duke shmangur përfundime për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Aftësia e gjyqtarit për respektimin e standardit minimal, nuk mund të barazohet vetëm me treguesin e shifrës apo të dhënës statistikore, pasi në rastin konkret ka qenë e mundur të analizohet dhe është bërë çdo dosje gjyqësore, ku çështja ka përfunduar tej standardit minimal, analizë nga ka rezultuar që zgjatja ka ardhur për shkak kompleksiteti, sjellje të palëve, respektimit të të drejtave procedurale të palëve dhe nevojës për hetim të plotë e gjithanshëm. Është pikëzuar me 5 pikë.

Për sa i përket, “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” është pikëzuar maksimal. Është rritur me një nivel në këtë rast, me të njëjtin arsyetim si dhe te standardi.

“Rendimenti i përfundimit të çështjeve” ka rezultuar në masën 93.9%, pasi sipas metodologjisë është pikëzuar me 8 pikë, duke qenë se ka pasur tejkalim të standardit mbi 50%, njëkohësisht një periudhë kohë gjyqtarja ka qenë me “barrë lindje” është rritur me një nivel (më i detajuar është në konkluzion), me 10 pikë.

“Koha mesatare e arsytimit të përfundimit të vendimit”, ka qenë më e shkurtër se afati për të gjitha kategoritë e çështjes. Është tejkaluar vetëm në një kategori, vetëm me 3 ditë, tejkalim i papërfillshëm. Është pikëzuar maksimalisht.

Është pikëzuar maksimalisht në, “Aftësinë për të kryer procedura gjyqësore”, si lidhur me “Numrin mesatar të seancave” ashtu edhe me “Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive”. Ka pasur numër të lartë seancash 7.5 seanca, por të gjitha këto të shkaktuara për shkak të kompleksitetit të çështjeve dhe në asnjë rast për shkaqe që lidhen me veprimet e gjyqtares, fakt i cili është konstatuar dhe nga raporti ynë analitik që kemi bërë për organet e rivlerësimit, edhe nga vendimi i tyre edhe nga Inspektori pranë KLD-së.

Për sa i përket “Saktësisë dhe plotësisë të dokumentacionit të dosjes” dhe “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes”, nuk janë gjetur të dhëna që mund të afektonin këto tregues. Për këtë arsye, është pikëzuar maksimalisht, dhe në përfundim për

kriterin e aftësive organizative është pikëzuar me 100 pikë.

Për kriterin e “Etikës dhe angazhimit të vlerave profesionale”, për të gjitha treguesit e këtij kriteri është pikëzuar maksimalisht. Për shkak të parimit të prezumimit nuk kanë rezultuar të dhëna që mund të afektonin ndonjë nga treguesit e këtij kriteri. Nuk ka pasur kërkesa për përjashtim gjyqtari, nuk ka pasur masa disiplinore, nuk ka përdorur gjuhën diskriminuese, nuk ka pasur të dhëna që mund të flasin për integritetin apo në drejtim të etikës së gjyqtarit dhe për këtë arsye është pikëzuar maksimalisht.

Për sa i përket kriterit të katërt “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, për aftësitë e komunikimit, bashkëpunimit me administratën dhe me trupën gjyqësore është vlerësuar maksimalisht. Gjithashtu, edhe për gatishmërinë e saj për t’u angazhuar në programin e trajnimit vazhdues, ka pasur 17 aktivitete trajnuese të shtrira në 33 ditë gjithashtu brenda programit dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës. Është pikëzuar me 20 pikë, për treguesin 4.C.a.

Për sa i përket, “Disponueshmërisë për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë ose për trajnim të gjyqtarëve”, ka pasur të dhëna sepse me urdhër të kryetarit të gjykatës është caktuar “gjyqtare udhëheqëse”, për kryerjen e praktikës para profesionale në vitin 2013, për gjyqtarët znj. {...}, {...}, {...} dhe për këtë arsye duke qenë se ka pasur të dhëna që ka pasur angazhime në mentorim, është pikëzuar me 5 pikë.

Për sa i përket “Angazhimit në veprimtarinë ndërinstitutionale për përmirësimin e drejtësisë”, ka pasur të dhëna lidhur me kontributin e gjyqtarës lidhur me kontributin e gjyqtarës për hartimin e ligjit të ri për falimentin, i provuar me dokumentacion, në bashkëpunim me International Finance Corporation (IFC) përgjatë periudhës 19 tetor – 30 nëntor 2015. Duke qenë se në këtë rast kontributi ka qenë efektiv i gjyqtarës, ka pasur dokumentacion, i vlerësuar dhe gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, është pikëzuar me 5 pikë.

Lidhur me “Publikimet ligjore dhe akademike”, nuk ka pasur të dhëna dhe është pikëzuar me 0 pikë.

Dhe përfundimisht për të katër kriteret propozohet niveli i pikëzimit dhe shkalla e aftësisë, 100 profesionali “shkëlqyeshëm”, 100, “Aftësia organizative”, “Shkëlqyeshëm”; 100 “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, “Shkëlqyeshëm”; 95 “Aftësia

personale dhe angazhimi profesional”. Në total niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 395.

Ilir Rusi: Faleminderit znj.Ukperaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, po vazhdojmë me votimin e projektvendimit në tërësi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Znj.Shehu, për shkak të përmbushjes së disa detyrimeve institucionale, po vazhdon mbledhjen online. Ilir, Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe

është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 21.11.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).⁶

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:28 dhe mbaroi në orën 13:11.

Në mbledhje ishin të pranishëm në sallë dhe online*:

- | | |
|-----------------------------------|---------------------------------|
| <i>11. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>12. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>13. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>14. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>15. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>16. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>17. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>18. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)*</i> |

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta sipas rendit të ditës.

19. Brikena Ukperaj (anëtare)

20. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Vjollca Kola, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Valbona Bala, eksperte EWMI.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Brikena Ukperaj*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës, që është pika e fundit e kësaj mbledhjeje, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën relatores *znj. Ukperaj*.

Brikena Ukperaj: Faleminderit z. Zëvendëskryetar!

Relacioni pasardhës ka të bëjë me ndryshimin e listës së gjyqtarëve udhëheqës,

për sa i përket praktikës profesionale të kandidatëve për gjyqtar në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës dhe konkretisht për magjistratët që ndjekin praktikën profesionale në Gjykatën Administrative të Shkollës së Parë Tiranë, ku dy mentorë, konkretisht znj. {...}, nuk mund të ushtrojë më funksionin e gjyqtarit sepse i mbaron statusi në datën 30 nëntor, dhe znj. {...}, është zgjedhur anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, mandati i të cilës fillon në datën 12 dhjetor.

Duke marrë parasysh që procesi i mentorimit duhet të ketë vijimësi, nga ana e komisionit është përgatitur relacioni. Unë shkurtimisht e thashë, nuk është e nevojshme sepse jeni njohur me relacionin.

Lidhur me përzgjedhjen e gjyqtarëve, në fakt kemi shumë pak gjyqtarë mentorë në Gjykatën Administrative të Shkollës së Parë Tiranë dhe disa prej tyre do të ngarkohen dhe me një apo dy, në një rast kemi dhe tre mentorime.

Është përgatitur dhe projekt-akti përkatës, në pikën e parë të së cilit parashikohet ndryshimi pjesërisht i listës së gjyqtarëve të caktuar me vendimin nr.466, datë 25.07.2013, duke zëvendësuar gjyqtarët udhëheqës: a) znj. {...} me gjyqtarin z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) dhe znj. {...} në cilësinë e gjyqtares udhëheqëse të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024); b) dhe për znj. {...} me znj. {...}, z. {...}.

Në pikën 2 është parashikuar që efektet juridike të këtij vendimi të fillojnë në datën 1 dhjetor, duke marrë parasysh që znj. {...} në datën 30 i mbaron statusi dhe njëkohësisht znj. {...} për 12 ditë të mos kishim shkëputje, por ta fillonte në dhjetor praktikën profesionale, kandidati për gjyqtar.

Është parashikuar dhe njoftimi i vendimeve, gjyqtarëve respektivë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim: “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023 gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, duke zëvendësuar gjyqtarët udhëheqës:

a) znj. {...} me gjyqtarët:

i) z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) dhe;

ii) znj. {...}, në cilësinë e gjyqtares udhëheqëse të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024);

b) znj. {...} me gjyqtarët:

i) znj. {...}, në cilësinë e gjyqtares udhëheqëse të kandidatit për magjistrat z. {...} dhe;

ii) z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magjistrat z. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024).

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë në datën 1 dhjetor 2023.

3. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjyqtarëve znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të

Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Pasdite të qetë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor